



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

1669
Nr. 1669 / prot. 17

Memaliaj më 31.07. .2025

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 30.07.2025 në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak në katin e parë të bashkisë Memaliaj.

Mbledhja drejtohet nga kryetari i këshillit bashkiak Memaliaj z.Erjon Sinanaj.

Ora e fillimit të mbledhjes është 10:00.

Këshilltarë të pranishëm 9 këshilltarë.

Mbledhja deklarohet e hapur.

Kryetari i këshillit: Përshëndetje koleg këshilltarë! Mbledhja sot zhvillohet në kushte ku administrata nuk na ka sjellë materiale pa ndonjë arsye. Është kërkuar një mbledhje jashtë radhe në datën 04.07.2025, e cila nuk është parë e mundur për t'u zhvilluar. U është kthyer përgjigje që nuk mund të zhvillohet mbledhje jashtë radhe dhe i kemi vendosur në rend dite sipas kërkesës së bërë nga kryetari i bashkisë.

Flamur Mushamati: Më kanë thënë që është kërkuar mbledhje jashtë radhe dhe kryesia nuk ka pranuar. Për sot nuk ka materiale arsyen nuk ma kanë thënë, por diçka si shkelje të ligjit nga ana e kryesisë, sepse nuk është bërë mbledhje jashtë radhe.

E. Sinanaj: Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të bëjë kërkesë për mbledhje jashtë radhe po jo gjithmonë mund të merren parasysh kërkesat si emergjente. Përgjigjia është kthyer nga ana e kryesisë. Vjen në mbledhje Znj.Afize Sula.

F. Mushamati: Unë mendoj që mbledhja të mos zhvillohet.

P. Lumani: Kryetari i Bashkisë ka kërkuar mbledhje për ndryshim buxheti, të cilën e kemi kaluar në muajin qershor dhe këshilltarët janë përgjigjur me votë. Ky është një bllof nga ana e administratës dhe ata protestojnë duke mos sjellë asnjë P/Vendim. Atë shqetësim që kam dhe bashkohem me kolegun tim Flamur që kjo mbledhje nuk ka kuptim që të djegim familjet në nevojë. Do të bejmë dhe një përpjekje për të mos rënë në lojë e shpifur dhe fëmijore nga ana e administratës.

Lauresha. Lila: Unë di që kryetari i bashkisë ka kërkuar 2 mbledhje jashtë radhe dhe ne si këshilltarë nuk dimë gjë dhe kryesia s'na ka vënë në dijeni, administrata është duke protestuar dhe nuk ka për të sjellë asnjë material.

Erjon Sinanaj/ kryetari i këshillit: Për mbledhjen jashtë radhe është mbledhur kryesia sipas

rregullores së këshillit dhe nuk e ka parë të arsyeshme zhvillimin e kësaj mbledhjeje prandaj nuk jeni njoftuar sepse nuk është bërë njoftim.

Esmerald Xhemali: Dje u mbledhën komisionet dhe nuk erdhi asnjë nga administrata

Arsola Muzha: Kam ardhur në 10:00, pasi kam pritur kam shkuar tek zyra e sekretarit të këshillit për të përpiluar shkresën, të cilën e kam protokolluar vetë te protokolli i bashkisë.

Afize Sula: Unë mendoj se kjo personale e kryetarit të bashkisë ndaj këshilltarëve është totalisht e pa vend. Ne kemi qenë konfort ligjit në punën tonë dhe kur administrata nuk ka qenë në lartësinë e duhur me relacione tepër të cunguara e megjithatë ne kemi qenë bashkëpunues. Në këto kushte s'ka të drejte kryetari i bashkisë të blokojë komunitetin nuk është problemi tek ne por kjo është punë dhe nuk duhet të kalojë në inate personale. Nëse kjo do të kalohej në inate personale do të ketë problem ai vete. Ky këshill ka përgatitjen dhe kulturën e duhur për të mos e ulur nivelin. Por ajo përgjigje nuk tregon profesionalizëm, por tregon dhe njëherë që institucioni ka të pa aftë që sillen me dallavere pazaresh.

Administratë e paaftë. Ju kërkoj t'i drejtohem me shkresë si keshill me të drejtën që na jep ligji për të kërkuar llogari ekzekutivit. vjen në mbledhje znj. Irena Jaupi.

Taulant Rama: Mua më shqetësojnë pasojat që sjell te qytetari duke ditur që administrata bën deformim të vendimeve të këshillit duke dezinformuar qytetarët. Kërkoj të bëhet një sqarin publik qytetarëve për situatën, që sot bashkia nuk ka sjellë asnjë material. Bën protestë duke parë armik imagjinar dhe duke influencuar për të marre vendime në dobi të bashkisë. Jam për qëndrim publik.

Petrit Lumani: Unë nuk jam partizan i përplasjeve do të thosha t'i japim mundësi, të bëjmë dhe një tentativë për t'i dhënë një zgjidhje.

Flamur Mushamati: Edhe unë jam dakord që kryesia të bashkëpunojë

Kryetari i njeh këshilltarët me rendin e ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.06.2025

3. Informacion mbi vendimet e marra në mbledhjen e datës 30.06.2025

4. Projekt vendim: "Për miratimin e propozimit të bashkisë Memaliaj për rishikimin në buxhetin e vitit 2025".

5. Informacion mbi masat paraprake për parandalimin e zjarrit dhe perballimin e emergjencave civile.

6. Informacion rezultatet e Barometrit Gjinnor në Bashkinë Memaliaj në bazë të legjislacionit shqiptar mbi barazine gjinore, realizuar nga Aleanca e Grave Këshilltare Bashkiake dhe Komisioni i Barazisë Gjinnore, me mbështetjen teknike të programit Bashki të Forta.

E. Xhemali: Nga situata e krijuar propozoj që pika 4 të hiqet nga rendi i ditës pasi administrata nuk është e pranishme për të relatuar dhe nuk kemi fare çfarë të diskutojmë dhe kujt t'ia drejtojmë pyetjet që kemi.

Kryetari e hedh ne votim rendin e ditës me ndryshime duke hequr pikën 4.

Vota Pro 7

Vota Kundër 2

Vota Abstenim 0. Miratohet.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30. 07. 2025.

Vota Pro 8

Vota Kundër 1

Vota Abstenim 1. Miratohet.

Pika 3 e rendit të ditës,

•Informacion mbi vendimet e marra më datë 30.06.2025.

Kryetari: Pika 4 e rendit të ditës nuk është pasi u miratua me ndryshime meqënëse nuk u paraqit asnjë nga administrata për ta mbrojtur as në mbledhje komisioni as në mbledhjen e këshillit, kalohet te pika tjetër.

Pika 5. Informacion për masat e marra nga MZSH për mbrojtjen nga zjarri.

Pika 6 kalohet pasi nuk ka të pranishëm për ta mbrojtur dhe sqaruar informacionin e pikës 5.

Kryetari i këshillit : Kjo mbledhje u realizua në këto kushte pa prapinë e administrates dhe pr rrjedhojë nuk u morë asnjë vendim e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Këshilltarë pjesëmarrës:

1. Irena Jaupi

2. Esmerald Xhemali

3. Arsola Muzha

4. Taulant Rama

5. Erjon Sinanaj

6. Afize Sula

7. Petrit Lumani

8. Maltona Bërxihi

9. Flamur Mushamati

10. Lauresha Lila

11. Argeri Muzo

Sekretari i Këshillit

Erjola Allka



Kryetari i Këshillit

Erjon Sinanaj

